



Duke u mbështetur në nenin 43 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenit 47 të Statutit të Komunës dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të interesuarit tjerë, që të marrin pjesë në seancën e **III-të të rregullt të punës për vitin 2019**. Seanca mbahet më **29.03.2019 (e premte)**, në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon në orën **10:00**.

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së. Për këtë seancë propozohet ky

RENDI I DITËS:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Pyetje dhe përgjigje,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për vënie në diskutim publik të Draft-rregullores për themelimin dhe strukturimin e Asamblesë Komunale të Fëmijëve (ref. Drejtoria e Arsimit),
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Ekzekutivit për vitin 2019 (ref. Ekzekutivi),
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për bartje të mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2018 në vitin 2019 (ref. Drejtori i FEZH),
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për kompensimin e shërbimeve te varrimit (refer.Drejtoria e Shërbimeve Publike),
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim –vendimit për miratim të nismës për bashkëpunim ndërkomunal Klinë-Istog (ref. Drejtoria e Shërbimeve Publike),
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për trasenë e rrugës transit të Klinës (ref. Drejtoria e Urbanizmit dhe MM),
10. Shqyrtimi dhe miratimi në pako i Rekomandimeve të MAPL dhe ministrit e linjës lidhur me:
 - Rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale - dhjetor 2018, (ref. Kryetari i Komisionit),
 - Statutin e Qendrës për Punë Sociale - dhjetor/2010 (ref. Drejtori i QPS), dhe
 - Vendimit-planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Klinës 2019,
11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e Këshillit Organizativ të Festivalit “I Këndojmë Lirisë” 2019 (ref. Drejtori për KRS),
12. Peticioni i banorëve të fshatit Budisalc.

01Nr. 06-11469 2019
Më 21.03.2019 2019

